



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 63/1 Prot.

Tiranë, më 16.01.2019

**V E N D I M**

Nr.5, datë 16.01.2019

***“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë së procesit të dhënies së masës disiplinore “Vërejtje”, (komunikuar me shkresën nr. 12220/3, prot., datë 24.10.2018), prej eprorit direkt, Kryetarit të Degës Doganore Tiranë, ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*\*, “Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër”, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, në Degën Doganore, Tiranë”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit nr. 840, prot., datë 05.11.2018, për disa pretendime të ngritura në lidhje me procedurën e procesit të dhënies së masës disiplinore “Vërejtje”, për punonjësen \*\*\*\*\*\*,

**VËREJ SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është depozituar një informacion i rregjistruar me nr. 840, prot., datë 05.11.2018, në të cilën kërkuesja \*\*\*\*\*\*, ngre pretendime për parregullsi procedurale në marrjen e masës disiplinore dhe shkelje flagrante të kryera në zbatimin material të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me parregullsi të lejuara gjatë kryerjes së procedimit disiplinor, në përfundim të të cilit është marrë masa disiplinore “Vërejtje”, komunikuar me shkresën nr.12220/3, prot., datë 24.10.2018, të Kryetarit të Degës së Doganave, Tiranë.

Në zbatim të verifikimit të ankesës, nëpërmjet shkresës nr. 840/2, datë 21.11.2018, *“Kërkim dokumentacioni për verifikimin e kërkesës të nëpunëses \*\*\*\*\*, në lidhje me ligjshmërinë e vendimit për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, komunikuar me shkresën nr. 12220/3, prot., datë 24.10.2018”*, është vënë në dijeni Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për këtë proces, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, nga institucioni është dërguar shkresa nr. 840/1 prot, datë 12.11.2018, drejtuar Komisionerit dhe së bashku me të, është dërguar edhe dokumentacioni përkatës, i cili është administruar në dosjen e materialeve të mbledhura gjatë shqyrtimit të ankesës.

Nga analiza e këtij rasti rezulton se, punonjësja \*\*\*\*\* është nëpunëse civile e konfirmuar, në pozicionin *“Doganier në Sektorin e Vlerës në Qendër, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër”* në Degën e Doganave, Tiranë.

Gjatë auditimit të ushtruar në institucionin e Degës Doganore Tiranë, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2015, sipas konkluzioneve të renditura në Raportin Përfundimtar të KLSH-së, *“Për auditimin e ushtruar në Degën e Doganës Tiranë”*, depozituar në Degën Doganore Tiranë, me shkresën nr. 5077/2, datë 20.09.2016, pretendohet se janë kryer shkelje të ndryshme në zbatimin e akteve të legjislacionit doganor, duke nënvizuar ndër të tjera dhe shkelje që përbënin zbatim të gabuar të referencave doganore që në tërësinë e tyre ishin mospërbushje e detyrave funksionale nga ana e nëpunëses \*\*\*\*\*.

Mbi bazën e këtyre rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Dega Doganore Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. 854 prot., datë 05.04.2017, e ka paraqitur rastin për shqyrtim pranë Komisionit Disiplinor, me arsyetimin se masat disiplinore të rekomanduara nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, janë të nivelit, nga ulje të nivelit të pagës përkohësisht, deri në largim nga shërbimi civil, masa të cilat sipas pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, janë në kompetencë lëndore të tij. Komisioni i Disiplinës, ka filluar shqyrtimin e këtij rasti, në disa seanca të njëpasnjëshme dhe gjatë hetimit administrativ është konstatuar se një pjesë e konkluzioneve të auditimit nuk ishin të sakta për shkak se shkeljet disiplinore nuk ishin kryer prej nëpunëses në fjalë, ose në veprimet e saj nuk gjendeshin elemente të shkeljeve të disiplinës.

Ndërkohë, në përputhje me situatën e krijuar, Kryetari i Degës së Doganës Tiranë, me shkresën nr. 12220/3 prot., datë 24.10.2018, drejtuar Komisionit Disiplinor, ka njoftuar këtë të fundit se, në përputhje me rekomandimet e lëna nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe rrethanat konkrete të çështjes, për shkeljet e përmendura në materialin e auditimit, në bazë të kompetencës që i njeh germa “a” e nenit 58, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, ka vendosur dhënien e masës

disiplinore “Vërejtje”, për nëpunësen \*\*\*\*\* dhe depozitimin e saj në dosjen personale të nëpunëses.

Pas marrjes së këtij informacioni, Komsioni Disiplinor, me Vendimin Përfundimtar nr. 24669/8, datë 01.11.2018, mbi “Ndërprerjen e ecurisë së masës disiplinore \*\*\*\*\*”, me arsyetimin se pranon vendimin e drejtuesit të Degës Doganore Tiranë që në cilësinë e eprorit direkt ka aplikuar masën disiplinore “vërejtje”, në zbatim të pikës 18 germa “a”, Kreu II, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Kodin Doganorë në shërbimin civil”, ka vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore.

Nga sa u parashtrua më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar konstatohet se në zhvillimin e ecurisë disiplinore dhe aplikimin e masës disiplinore “vërejtje”, janë kryer disa shkelje të dispozitave materiale e procedurale, që rregullojnë zhvillimin e procedimit disiplinor.

Së pari, Komisioni i Disiplinës, në mënyrë të padrejtë ka ndërprerë ecurinë disiplinore me të marrë dijeni se, për të njëjtat arsye, Kryetari i Degës Doganore Tiranë, me cilësinë e eprorit direkt të punonjësës \*\*\*\*\*, kishte aplikuar masën disiplinore “vërejtje”. Shkeljet e evidentuara në materialin e auditimit të KLSH, janë cilësuar të tilla, që ndaj tyre rekomandohej të aplikoheshin masa disiplinore nga germa “b” (*mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj*) deri në gërmën “ç” (*largim nga shërbimi civil*) të nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, masa këto që në bazë të pikës 2, të nenit 59, të ligjit në fjalë, janë në kompetencë të Komisionit Disiplinor.

Në këto kushte, Komisioni i Disiplinës, nuk kishte asnjë bazë ligjore të ndërpriste ecurinë disiplinore, me arsyetimin se eprori direkt ndërkohë, kishte aplikuar pavarësisht komisionit të disiplinës, masën disiplinore “vërejtje”, por duhej të vazhdonte shqyrtimin e rastit deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.

Së dyti, masa disiplinore e aplikuar nga eprori direkt, është e kundraligjshme, pasi prej tij, është zhvilluar një procedim disiplinor i cili nuk ishte në kompetencën e tij, por në kompetencën e Komisionit të Disiplinës. Vetëm nëse Komisioni i Disiplinës, në përfundim të procedimit administrativ, do të arrinte në përfundimin se shkeljet e konstatuara nga organi auditues, nuk janë të asaj natyre për të cilat duhet të aplikohen masa të rënda disiplinore (*pikat “b” deri “ç”, të nenit 58, të ligjit 152/2013*), por masa më të lehta disiplinore, mund të dërgonte çështjen për kompetencë, tek eprori direkt për shqyrtim.

Së treti, eprori direkt, nuk ka zhvilluar një procedurë të rregullt disiplinore, ku të fillonte me aktin për fillimin e ecurisë disiplinore prej tij, të vazhdonte me aktin e njoimit të ecurisë disiplinore e më pas të vijonte me kryerjen e seancës dëgjimore, ku të

administronte thëniet e nëpunësit në mbrojtje, të shqyrtonte dokumentacionin provues, të paraqitur nga palët e interesuara dhe në përfundim të merrte vendimin për aplikimin e masës disiplinore që do e çmonte të përshtatshme. Mosrespektimi i procedurës në këtë rast, në bazë të nenit 108, pika “a”, nënpika ii), të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH” e bën aktin e dhënies së masës disiplinore “vërejtje”, nr. 12220/3 prot., datë 24.10.2018, një akt absolutisht të pavlefshëm, i cili në bazë të nenit 110, të ligjit në fjalë, nuk mund të sjellë asnjë pasojë juridike, pasi konsiderohet se nuk ekziston.

Së katërti, masa disiplinore “vërejtje” ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*, aplikuar prej eprorit të saj direkt, nga pikëpamja materiale, është marrë në kundërshtim me kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 8, e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, sipas të cilit “*procedimi disiplinor fillon pa vonesë, me marrjen dijani për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda një afati 2-vjeçar nga data e kryerjes së shkeljes*”.

Në rastin konkret, momenti i konstatimit të shkeljes është çasti i depozitimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Degën Doganore Tiranë, me shkresën nr. 5077/2, datë 20.09.2016. Ky moment, në raport me kohën kur është marrë masa disiplinore, me aktin nr. 12220/3 prot., datë 24.10.2018, rezulton se ka kaluar afati dy vjeçar brenda të cilit mund të aplikohet masa disiplinore. Për më tepër, koha e aplikimit të masës disiplinore, në raport me kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar (*auditimi nga ana e KLSH-së është kryer për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2015*), është edhe më shumë se dy vjet.

Ky fakt, bazuar në përmbajtjen e nenit 108, gërma “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH” përbën shkak tjetër për pavlefshmëri absolute (*pasi është një rast dekadence, i parashikuar shprehimisht në ligj*) të aktit administrativ për dhënien e masës disiplinore në fjalë.

Nisur nga gjithë sa është parashtruar më sipër, arrihet në përfundimin se, akti nr.12220/3 prot., datë 24.10.2018, me anë të të cilit materializohet dhënia e masës disiplinore “vërejtje” ndaj nëpunëses \*\*\*\*\*, prej eprorit direkt, Kryetarit të Degës Doganore Tiranë, për gjithë arsyet e përmendura më sipër, në bazë të nenit 108 pika “a”/ii) dhe “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH” është një akt absolutisht i pavlefshëm, gjë që në kuptim të neneve 110 dhe 111, të ligjit në fjalë, konsiderohet se nuk ekziston dhe nuk mund të sjellë pasoja juridike.

#### **Për këto arsye:**

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

## **VENDOSA:**

1. Organi publik, drejtuesi i Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr.12220/3 prot., datë 24.10.2018, të Drejtuesit të Degës Doganore Tiranë, me anë të të cilit materializohet dhënia e masës disiplinore “*vërejtje*” ndaj nëpunëses \*\*\*\*\* dhe mbi këtë bazë të anulojë aktin e mësipërm.
2. Të hiqet akti i mësipërm i masës disiplinore nga dosja e personelit të nëpunëses \*\*\*\*\* dhe të fshihen shënimet e bëra.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**